



Pozicioni: Ekspert në shkrimin e projekteve

Lloji i punës: Part-time

Data e fillimit: 01 shkurt 2023

Organizata: Qendra “Streha”

Informacion i Përgjithshëm

“Streha” është qendër rezidenciale e cila mbështet të rinjtë LGBTI të disavantazuar dhe të diskriminuar, me shërbime të tilla si: akomodim dhe plotësim i nevojave bazë, kurse profesionale, ndërmjetësim për punësim, rritje e aftësive për jetën, këshillim psikologjik, etj.

Eksperti do të jetë përgjegjës për shkrimin e projekt propozimeve, hulumtimin dhe ndjekjen e thirrjeve në burime të ndryshme të financimit publik dhe privat. Eksperti shkruet i projekteve do të jetë përgjegjës për pajtueshmërinë me kërkesat e financimit, asistimin në përgatitjen e buxhetit dhe asistimin e procesit të implementimit pas dhënies së projektit.

Përgjegjësitë e Ekspertit:

- Hulumtimi dhe ndjekja e thirrjeve për projekte dhe grante në burime të ndryshme financimi publik dhe privat.
- Shkrimi i projekt propozimeve.
- Asistim në përgatitjen e buxhetimit të projektit dhe verifikim të pajtueshmërisë me termat e kërkesës financiare.
- Komunikon në mënyrë efektive me aktorë të ndryshëm të dhe të jashtëm.
- Realizon me cilësi gjithë sa më sipër dhe brenda kohëzgjatjes së kërkuar.

Përgjegjësitë e Qendrës “Streha”

Qendra “Streha” është përgjegjëse për të lehtësuar mbarëvajtjen e punës duke ofruar ndihmën për çdo mjet dhe informacion të nevojshëm për realizimin e tij. Do të mbikqyrë punën e realizuar brenda kërkesave.



Aftësitë dhe eksperiencat e nevojshme

Njohuri rreth situatës së të drejtave dhe shërbimeve të komunitetit LGBT+ në Shqipëri.

- Diplomë universitare dhe të paktën 3 vjet përvojë pune me organizata lokale/ ndërkombëtare si shkruar dhe/ose menaxhues projektesh ose aktivitete të ngjashme.
- Të jetë person i organizuar mirë, i aftë për ti dhënë përparësi detyrave.
- Aftësi për të mbajtur standarde të mira pune dhe kur punon nën presion.
- Aftësi të mira ndërpersonale dhe komunikative.
- Aftësi të mira bashkëpunuese për punë në grup.
- Njohje shumë e mirë e gjuhës angleze.
- Njohuri rreth platformave të ndryshme të thirrjeve për projekte lokale dhe ndërkombëtare.

Pranimi i aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin: a) letër interesi b) CV në gjuhën angleze c)një portofol me punë që përfshin 2-3 projekt propozime të shkruara prej tyre

Afati i dorëzimit të aplikimit është data **28 Janar 2023** në adresën strehalgbt@gmail.com.

Përzgjedhja e ekspertit

Përzgjedhja e ekspertit do të realizohet në sajë të përputhshmërisë së aplikimit me kërkesat që përmbajnë Termat e Referencës.

Ne vlerësojmë diversitetin dhe përfshirjen dhe inkurajojmë të gjithë njerëzit e kualifikuar që të aplikojnë pavarësisht nga identiteti i tyre gjinor, etnia dhe feja. Ne inkurajojmë fuqimisht komunitetin LGBTQ të aplikojë.